

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

No. Prot: PR-0034

Data: 20.04.2026

FTESE PER OFERTE

I nderuar Partner,

E themeluar ne vitin 1995, ne jemi pjese e grupit nderkombetar ProCredit. Ne jemi te mbikqyrur nga autoritete te larta te supervizimit gjerman, Bundesbank dhe BaFin qe sigurojne besueshmerine dhe qendrueshmerine tone.

Qendrueshmeria dhe besueshmeria jone, garantohet gjithashtu nga aksioneret tane. Ne jemi nje banke me nje kapital 100 % gjerman dhe aksioneri yne i vetem eshte ProCredit Holding, me qender ne Frankfurt, Gjermani, i cili ofron drejtim strategjik per grupin e bankave ProCredit.

I. Hyrje

Banka ProCredit eshte e interesuar per nevoja te saj realizimin e sherbimit taksi per punonjesit e saj. Per kete, Banka kerkon te bashkepunoje me shoqeri te cilat permbushin te gjitha kerkesat dhe kualifikimet e duhura per kryerjen e e ketij sherbimi.

Ju do te gjeni bashkangjitur kesaj ftese, Aneksin 1, ku paraqiten specifikimet e sherbimit per te cilat Banka eshte e interesuar.

Nderkohe, cmimet qe do te aplikohen do te jene ato qe shoqeria e perzgjedhur do te kete ofertuar ne Aneksin 1, qe do te jete pjese integrale e kontrates se bashkepunimit.

II. Objekti i Fteses per Oferte

Sherbim taksi per punonjesit e ProCredit Bank sh.a.

Kjo Ftese per Oferte perbehet nga:

1. Ftesa per oferte	3 faqe
2. Aneksi Nr. 1	2 faqe
3. Aneksi Nr. 2	1 faqe
4. Aneksi Nr. 3	1 faqe
5. Deklarata e gjendjes gjyqesore	1 faqe
6. Deklarata e njohjes dhe perputhshmerise	2 faqe
7. Formulari ofertes	1 faqe

III. Oferta

Oferta juaj duhet te perbehet nga:

A. Oferta Ligjore, e cila paraqet *Kriteret e Pranimit/Kualifikimit dhe duhet te perpilohet sipas kerkesave te renditura me poshte.*

1. Ekstraktit historik per te dhenat e subjektit leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit.
2. Nje dokument qe verteton se subjekti juaj i ka paguar detyrimet tatimore, leshuar nga Administrata Tatimore.
3. Nje dokument qe verteton se subjekti juaj i ka paguar sigurimet shoqerore, leshuar nga Administrata Tatimore.
4. Deklarate per gjendjen gjyqesore te shoqerise sipas formatit bashkengjitur kesaj ftese per oferte.
5. License per ushtrimin e sherbimit taxi per automjetet qe shoqeria disponon.

6

Shenim:

Dokumentacioni i kerkuar ne Kriteret e Pranimit/Kualifikimi ne pikat nga 1 2 dhe 3, duhet te vertetohet permes dokumentave te leshuar jo me pare se tre muaj nga data e fundit e dorezimit te ofertes. Dokumentat e mesiperme mund te paraqiten origjinal/ te noterizuar ose kopje te dokumentave origjinale. Ofertuesit te shpallur fitues do ti kerkohet ky dokumentacion ne origjinal ose fotokopje te noterizuar.

B. Oferta teknike (Kriteret e vleresimit te cilesise)

1. Kapaciteti teknik profesional dhe eksperienca te ngjashme

Shoqeria juaj, duhet te provoje se disponon aftesite teknike dhe profesionale per realizimin e objektit te kerkuar, ne kete proces tenderimi permes dokumentacionit si me poshte:

- CV e detajuar e shoqerise suaj per aktivitetin qe nga data e themelimit ku te perfshihen te gjitha eksperiencat tuaja te meparshme, vecanerisht ato qe lidhen me sherbimin e kerkuar. Pjese e CV-se duhet te jete dhe perberja e stafit (i ndare sipas numrit te shofereve dhe stafit tjetere te angazhuar ne kete sherbim)) qe do te angazhohet per kryerjen e ketij sherbimi, ku te detajohet eksperienca e tyre profesionale apo cdo sqarim shtese qe konfirmon kualifikimin e tyre per kryerjen e sherbimeve te kerkuara.
- Leter reference leshuar nga institucione te ndryshme private apo publike per te cilet shoqeria juaj ka kryer sherbime te ngjashme se bashku me kopjet e kontratave perkatese.
- Informacion i detajuar per llojin , numrin, vitin e prodhimit dhe llojin e karburantit qe perdorin automjetet qe shoqeria juaj disponon.
- **Kriter skualifikues: Me shume se 80% e makinave te flotes duhet te jene makina elektrike.**

Shoqeria e perzgjedhur fituese ne menyre te detyrueshme do te caktojte nje person qe do te sherbeje si "menaxher i kontrates", i cili ne bashkepunim te ngushte me punonjesit pergjegjes te Bankes ProCredit, do te kordinoje procesin per realizimin e kushteve te kontrates.

Ne vijim te dokumentacionit te kerkuar me lart lutemi te dergoni nese dispononi , kopje te certifikatave ISO.

Shoqeria ofertuese mund te bashkangjese edhe dokumente shtese, te cilat mendon se do ta qartesojne me mire oferten e tyre

Bashkengjitur me kete Ftese per Oferte do te gjeni Deklaraten e Njohjes dhe Perputhshmerise si edhe Deklaraten mbi Gjendjen Gjyqesore te cilat duhet te firmosen nga perfaqesues te subjektit tuaj dhe duhet te shoqerojne oferten tekniko-ligjore.

C. Oferta Ekonomike

Oferta ekonomike duhet t'u permbahet kerkesave te Aneksit Nr. 1, bashkangjitur kesaj ftese per oferte. Cmimet e ofruara duhet te perfshijne TVSH-ne dhe monedha e kuotuar duhet te jete ne Leke.

Formulari i Ofertes: Bashkangjitur me ftesen per oferte eshte Formulari i Ofertes i cili duhet te firmoset/vulohet nga shoqeria juaj dhe te dergohet se bashku me oferten ekonomike.

IV. Dorezimi i Ofertes

Oferta juaj duhet te dergohet ndarazi:

1. Dokumentacioni ligjor dhe teknik duhet te dorezohet ne forme elektronike ne adresen : info_procurement@procredit-group.com;
2. Oferta ekonomike do te dorezohet ne zarf te mbyllur sqaruar si me poshte.

Zarfi i ofertes ekonomike duhet te jete te vulosur nga shoqeria ne pjesen e ngjitjes se tij ku duhet te jete shkruar qarte: **Sherbim taksi per punonjesit e ProCredit Bank sh.a. dhe Emrin e Shoqerise** qe e dergon. Zarfi duhet te protokollohet prane

receptionit te Zyrave Qendrore te PCB-se dhe shoqeria duhet te sigurohet qe kjo oferte eshte protokolluar. Per te shmangur cdo paqartesi, kerkojme qe perfaqesuesi i shoqerise te mos largohet nga Zyrtat Qendrore te PCB-se pa marre numrin e protokollit te ofertes.

Ne rast se oferta juaj ekonomike dorezohet e hapur, me e-mail, fax ose ne ndonje menyre tjeter nga ajo e kerkuar me lart, oferta nuk do te konsiderohet e vlefshme.

Oferta juaj, ne formatin e kerkuar do te adresohen dhe paraqiten ne:

Ref: RFO-06-04-2026

Sherbim taksi per punonjesit e ProCredit Bank sh.a.

ProCredit Bank sh.a.
Rr. Dritan Hoxha, prane Pallatit e Sportit "Asllan Rusi",
Ndertesha e Zyrave Qendrore, Kati 0,
Tirane

V. Vleresimi Ofertes

- Pas shqyrtimit te ofertes tekniko – ligjore, Banka procedon me vleresimin e ofertes financiare. Banka ne perfundim te ketij procesi do te bashkepusoje me shoqerine/shoqerite qe ka/kane ofruar oferten me te pershtatshme per te.
- Banka do te njoftoje me shkrim, nepermjet email nese jeni perzgjedhur ose jo fitues.
- Banka ruan te drejten e perzgjedhjes se nje apo me shume shoqerive per plotesimin e ketyre kerkesave.

VI. Afati i dorezimit

Afati i fundit per dorezimin e ofertave ne Banke, ne adresen e mesiperme eshte **date 4 Maj 2026 ora 16.00.**

Per cdo pyetje ju lutem mos hezitoni t'i adresoni ne: info_procurement@procredit-group.com.

Per cdo ankese ne lidhje me vendimin per procesin e prokurimit ju lutemi mos hezitoni t'i adresoni ne: albankesaprokurime@procredit-group.com

Ju lutem percaktoni ne oferten tuaj menyren e marrjes se kesaj Ftese per Oferte duke vendosur nje kryq per nje nga menytrat e meposhtme:

- | | |
|--------------------------------|-------|
| a) derguar me email nga banka | _____ |
| b) nepermjet internetit | _____ |
| c) eshte terhequr prane bankes | _____ |
| d) nga shoqeri te tjera | _____ |

Sinqerisht,
ProCredit Bank sh.a



Aneksi Nr. 1**A: Specifika te vecanta per sherbimin:**

- Automjete te branduara me logon e sherbimit te taksise sipas legjislacionit ne fuqi.
- Drejtuesit e automjeteve te jene te veshur me uniforma te njejta sipas modelit te percaktuar nga shoqeria juaj.
- Ambjenti brenda automjeteve te jete i paster dhe i ajrosur.
- Te gjitha automjetet qe do te perdoren duhen te jene te pajisura me kondicioner.
- Afati i pergjigjes per sherbimin nga momenti i kerkeses se Bankes jo me shume se 10-15 minuta.

B: Oferta e ekonomike e cila duhet te plotesohet sipas kerkesave te meposhtme:

1. Sherbimi Urban brenda Tiranes

Zona	Distanca	Sherbim taksi nga ora 07.00-22.00		Sherbim taksi per ditet e festave dhe oret e nates 22.00-07.00	
		Tarifa per km (ALL me TVSH)	Tarifa per min (ALL me TVSH)	Tarifa per km (ALL me TVSH)	Tarifa per min (ALL me TVSH)
Nga pika e nisjes	deri ne 1.5 km				
Zona A	5.5 km e tjere pas 1.5 km te pare				
Zona B	10 km e tjera pas 1.5 km + 5.5 km				
Zona C	mbi 17 km				

2. Sherbim taxi drejt destinacioneve te meposhtme:

Destinacionet vajtje ose anasjelltas	Oferta ne Leke (Bashke me TVSH)
Tirane - Aeroporti Rinas	
Tirane - Durres	
Tirane - Elbasan	
Aeroporti Rinas - Durres	
Aeroporti Rinas - Elbasan	

Lutemi oferten tuaj te shprehur ne Leke , perfshire te gjitha detyrimet tatimore per kete sherbim

Shenim i rendesishem:

Ju lutemi te specifikoni uljen qe do te aplikoni si % te vleres totale te fatures mujore

Sgarim:

- Cmimet e ofruara duhet te perfshijne te gjithë detyrimet tatimore. Monedha e kuotuar duhet te jete ne Leke. Ne cdo rast te ofertimit ne nje monedhe te ndryshme nga Leke, per reference do te merret kursi i kembimit i Bankes se Shqiperise ne daten e fundit te dorezimit te ofertave.
- Vlefshmeria e ofertes duhet te jete gjashte muaj (180 dite) nga data e dorezimit.
- Çmimet ofertuese duhet te jene fikse dhe do te mbeten te pandryshuara deri ne perfundim te kontrates.
- Ofertuesit duhet te garantojne realizimin e dhenjes se sherbimeve te siperpermendura sipas kushteve te ofertuara
- Shoqeria/te fituese duhet te ruaje/ne ne konfidence dhe duhet te mos shpalos asnje informate qe i zbulohet para dhe gjate kohezgjatjes se kontrates e deri ne kohe te pakufizuar te palet e tjera.
- Ofertuesi duhet te jete i gatshem per ofrimin e sherbimeve menjehere pas lajmerimit nga banka se oferta e tyre ka qene e sukseshme.
- Asnje shpenzim qe shoqerite ofertuese bejne gjate pergatitjes dhe dorezimit te kuotimit te çmimit nuk do te kompensohet.
- Banka ProCredit ka te drejte te anuloje tenderin dhe/ose ndryshoje karakteristikat e tenderit dhe ti ftoje pjesemarresit per te sjelle serish ofertat e tyre

Aneksi Nr. 2

Referenca per kontrata te ngjashme

Nr	Klienti	Data e fillimit te kontrates	Data e perfundimit te kontrates	Qyteti ku eshte ofruar sherbimi	Personi kontaktit/pozicioni	Numri i telefonit te personit te kontaktit
1	XXXXXXXXX	1 Janar 2017	30 Dhjetor 2018	Tirane	068xxxx
2	YYYYYYYYY	15 Mars 2016	15 Qershor 2016	Durres, Lezhe	068xxxx
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						
Etj						

Shenim: Shembujt e mesiperme jane dhene per te treguar si duhet te plotesohet tabela e referencave

Aneksi Nr. 3:

Kushtet paraprake te kontrates

Banka ruan te drejten e ndryshimit te ketyre kushteve paraprake:

1. Objekti i kontrates: Sherbim taxi per punonjesit e bankes ProCredit sh.a.
2. Sherbimi do te kryhet me automjete te licensuara dhe sipas kerkesave te Bankes. Gjendja e automjeteve duhet te jete shume e mire dhe sherbimi duhet te kryhet me korrektesi dhe profesionalizem.
3. Kontrata per kete sherbim hyn ne fuqi me nenshkrimin e dhe eshte e vlefshme per nje periudhe ____ vjecare.
4. Pagesa e çmimit te sherbimitdo te kryhet pas perfundimit te sherbimit ne llogarine bankare te shoqerise prane bankes ProCredit sh.a brenda 30 diteve nga kryerja e sherbimit dhe paraqitjes se fatures tatimore nga ana e shoqerise. Ofertuesi i shpallur fitues perpara nenshkrimit te kontrates **duhet te hap llogari prane bankes ProCredit sh.a.**
5. Stafi i Bankes qe kryen levizje me taksi, nuk do te kryeje pagese por do te firmose kuponat, te cilat njehere ne muaj rakordohen me perfaqesuesin e Bankes dhe vijohet me leshimin e fatures tatimore nga ofruesi i sherbimit dhe me pagesen nga Banka.
6. Secila nga palet ka te drejte te zgjidhe kete kontrate duke njoftuar paraprakisht palen tjetere te pakten 1 (nje) muaj perpara
7. Konfidencialiteti: Secila nga palet do te ruajne konfidenciale çdo informacion te fituar gjate ekzekutimit te kesaj

DEKLARATE MBI GJENDJEN GJYQESORE

E shoqerise pjesemarrrese ne proceduren e prokurimit qe do te zhvillohet ne date _____ nga Banka ProCredit sh.a. me objekt _____

Une i nenshkuari _____ me cilesine _____ te shoqerise _____ deklaroj se:

- Shoqeria _____ nuk eshte denuar per shkelje penale,
- Shoqeria _____ nuk eshte denuar me vendim te gjykates se formes se prere, qe lidhet me aktivitetin profesional,
- Shoqeria _____ nuk eshte ne proces falimentimi

Data e dorezimit te deklarates _____

Perfaqesuesi i ofertuesit

Nenshkrimi

Vula

Deklarata e Njohjes dhe Perputhshmerise

Grupi ProCredit pranon se ndikimet etike, sociale dhe mjedisore qendrojnë brenda zinxhirit të furnizimit. Për më tepër, ndikimet pozitive mund të arrihen nëpërmjet blerjes së produkteve dhe/ose shërbimeve me të përgjegjshme dhe duke punuar në bashkëpunim me furnizuesit për të ndikuar pozitivisht reciprokisht në performancën etike, sociale dhe mjedisore. Prandaj, grupi ProCredit pret që furnizuesit/kontraktoret e tij të angazhohen për një sërë standardesh minimale për të siguruar që angazhimi i tyre ndaj çështjeve kyçe sociale, mjedisore dhe qeverisëse janë në përputhje me standardet e larta të ProCredit.

1. Perputhshmeria me Listen Perjashtimore të ProCredit

Siç është rasti me klientet e tij, grupi ProCredit pret që furnizuesit dhe kontraktoret e tij të mos angazhohen në asnjë prej aktiviteteve të listuara në Listen Perjashtimore të ProCredit. Në përgjithësi kjo listë përfshin, por nuk kufizohet në sa vijon:

i. Prodhimi ose aktivitetet që përfshijnë forma të demshme ose shfrytëzuese të punës së detyruar/punës së demshme të femijëve, praktika diskriminuese ose praktika që pengojnë punonjësit të ushtrojnë ligjërisht të drejtat e tyre të shoqërisë dhe marrëveshjeve kolektive (shih pikën a) të Listës së Perjashtimit për detaje të mëtejshme)

ii. Respektimi i ligjeve ose rregulloreve kombëtare, si dhe i konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në lidhje me prodhimin dhe/ose tregtimin e çdo produkti ose aktiviteti (shih pikën w) të Listës Perjashtimore për detaje të mëtejshme)

2. Pastrimi i parave

Grupi ProCredit pret që furnizuesit e tij t'u përmbahen vlerave etike të grupit ProCredit dhe të konfirmojnë se ata nuk marrin pjesë në asnjë nga format e pastrimit të parave (shih gjithashtu Kodin e Sjelljes).

3. Parandalimi i korrupsionit dhe mashtrimit

Siç përkrahë në Kodin e Sjelljes, grupi ProCredit nuk toleron rryshfetet ose korrupsionin. Për këtë arsye, asnjë marrëdhënie biznesi nuk mund të krijohet ose të vazhdojë, nëse një furnizues i mundshëm mendohet të jetë i përfshirë në korrupsion dhe/ose mashtrim. Kjo shërben për të theksuar se grupi ProCredit nuk pranon asnjë rryshfet të çfarëdo forme dhe nuk i lejon furnizuesit të angazhohen në praktika të tilla. Çdo furnizues ose kontraktor që zbulohet se është i përfshirë në aktivitete të kësaj natyre do të përjashtohet nga të qenit partner i mundshëm.

4. Respektimi i të drejtave të njeriut

Grupi ProCredit ndjek Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (1948) dhe pret që furnizuesit dhe kontraktoret e tij të bëjnë të njëjten gjë.

5. Shëndeti, siguria, sigurimi dhe mjedisi (SHSSM)

Grupi ProCredit pret që furnizuesit e tij t'i marrin seriozisht çështjet e SHSSM duke u siguruar që të jenë në linjë me dhe në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi në lidhje me SHSSM.

Grupi ProCredit pret që furnizuesit e tij të angazhohen dhe t'u përmbahen me vërtetësi standardeve të përcaktuara në këtë dokument. Furnizuesit priten të tregojnë përkushtimin e tyre duke bashkëpunuar ngushtë me grupin ProCredit dhe duke ofruar akses të arsyeshëm në dokumentacionin/informacionin përkatës nëse gjykohet e nevojshme. Në rast të shkeljeve serioze dhe/ose të vazhdueshme të standardeve të përcaktuara këtu, grupi ProCredit do të ndermarre hapat e nevojshëm për të nderprerë marrëdhënien e biznesit.

Me nenshkrimin e ketij dokumenti, nenshkruesit konfirmojne autoritetin e tyre per te nenshkruar ne emer te furnizuesit dhe per t'u angazhuar per standardet e percaktuara ne kete dokument.

Deklarata te nenshkruhet nga furnizuesi/kontraktori

Emri i kompanise _____

Numri i regjistrimit (nese ka) _____

Numri i kontrates/tenderit (nese ka) _____

Adresa _____

Emri dhe titulli i nenshkruesit _____

FORMULAR OFERTE

[Ofertuesi duhet te plotesoje kete Formular ne perputhje me udhezimet e treguara. Nuk lejohen ndryshime apo zevendesim te ketij formati.]

Date: ____/____/____
[plotesoni daten (dite,muaj,vit) e dorezimit te ofertes]
Numri i fteses RFO-06-04-2026

**Njesia e Prokurimit
Tirane, Shqiperi**

Ne, te nenshkruarit, deklarojme qe:

- (a) Ne kemi shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur ne kete procedure prokurimi dhe pranojme, pa rezerva ose perjashtime, kerkesat, afatet dhe kushtet e shprehura ne to;
- (b) Ne sigurojme ofrimin e sherbimit ne perputhje me Dokumentat e Tenderit dhe afatet e levrimin sipas informacionit te dhene ne keto dokumenta.
- (c) Ne permbushim gjithë kerkesat ligjore, financiare-ekonomike dhe teknike te specifikuara ne dokumentat e tenderit si vertetohet nga certifikatat dhe dokumentat e dorezuara me kete deklarate.
- (d) Cmimi total i Ofertes sone, perfshire cdo detyrim tatimor eshte: _____ n/a _____ *[plotesoni cmimin total te ofertes me numra dhe fjale, si dhe monedhen];*
- (e) Oferta jone do te jete e vlefshme nga data e dorezimit te ofertes deri me date.....;
- (f) Ne nuk kemi konflikt interesi ne perputhje me Deklaraten e Njohjes dhe Perputhshmerise;
- (g) Ne kuptojme se kjo oferte, sebashku me njoftimin tuaj zyrtar te shpalljes se fituesit do te sherbeje si nje kontrate e perkohshme ndermjet nesh, derisa te pergatitet dhe nenshkruhet kontrata zyrtare.
- (k) Ne kuptojme qe nuk jeni te detyruar te pranoni oferten me cmimin me te ulet ose çdo oferte tjeter qe ju mund te mermi.

Firmosur: _____

Date: _____